



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"  
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË

Nr. 10P Prot.

Vlorë, më 14/11/2017

**Lënda:** Relacion mbi nisjen e vitit akademik 2017-2018

**Drejtuar:** Rektorit Prof.Dr. Luan GJONÇAJ,

Zv/Rektorit PhD. Siri HOXHA

Më datë 16/10/2017 nisi zyrtarisht viti i ri akademik 2017-2018 në Kolegjin Universitar "Pavarësia Vlorë", për ciklin e parë dhe të dytë (viti i dytë) të studimeve, me Urdhër Nr.418, datë 20.09.2017 nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), "Për caktimin e datës së fillimit të Vitit Akademik 2017-2018 në Institucionet e Arsimit të Lartë".

Oraret e të gjithë programeve të studimit janë afishuar edhe në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" ([www.unipavaresia.edu.al](http://www.unipavaresia.edu.al)), në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të aksesueshme nga studentët.

Orët e leksioneve dhe seminareve janë zhvilluar në normalitet duke patur një pjesëmarrje të kënaqshme. Secili program studimi zhvillon **jo më tepër se pesë orë mësimore në ditë**.

NJBSC dhe anëtarët e saj janë angazhuar maksimalisht në monitorimin e të gjitha proceseve në respektimin dhe funksionimin e tyre në zbatim të rregullores institucionale.

Të regjistruar sipas të dhënave të marra nga sekretaria qendrore e KUPV, për vitin akademik 2017-2018 janë respektivisht sipas programeve të studimit:

- a. Bachelor në Drejtësi 20 studentë
- b. Bachelor në Ekonomi 28 studentë
- c. Bachelor në Shkenca Politike 6 studentë
- d. Bachelor në Inxhinieri Informatike 14 studentë
- e. Master i Shkencave (Pi) në Arkitekturë 5 studentë
- f. Master i Shkencave në Financë Publike dhe Adminsitrim Publik 36 studentë
- g. Master i Shkencave në E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare Publike 20 studentë
- h. Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike 10 studentë
- i. Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike 8 studentë
- j. Master i Shkencave në Diplomaci dhe Politikë Ndërkombëtare 1 student
- k. Master Profesional në Financë dhe Kontabiliteti i Firmave 16 studentë



Numri total i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë në ciklin e parë të studimit janë 27 studentë.

Numri total i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë në ciklin e dytë të studimit janë 86 studentë.

Numri total i studentëve të transferuar në ciklin e parë të studimit janë 46 studentë.

Numri total i studentëve të transferuar në ciklin e dytë të studimit janë 5 studentë.

Numri total i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2017-2018 është 164 studentë.

Duke Ju falenderuar për bashkepunimin,

**Kryetar i NJBSC**

**MSc. Anduel MEHMETI**